**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-25-3807-5-2-1/C1047**
**14 Nr. 539/25**
**Dt. 24.06.2025**

# KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PUNËDHËNËSI)** , dhe

2. **GOE " Ideal Partners "sh.p.k., emri i biznesit, me ARBK: 811913997, me seli në Drenas** & " 2D Group Corporation "sh.p.k. emri i biznesit, me ARBK : 811913913, me seli në Prishtinë, të cilët i përfaqëson **z. Kushtrim Berisha**, në tekstin e mëtejmë: K**RYESI I PUNËVE**

janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për punë, me sa vijon : **Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit në fsh. Ashlan dhe Parkut te banesat e bardha** , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i prokurimit** | **VU644** | **2** | **5** | **38** | **0** | **7** | **5** | **2** | **1** |
| **Nr. i brendshëm** | **VU644** | **2** | **5** | **0** | **2** | **9** | **5** | **2** | **1** |

**Neni 1 Lënda**
Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, sipas projektit, dokumentacionit standard si dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **VU644-25-029-521**

1.1 **Afati i fillimit të punimeve është 4 ( katër ) ditë** pas nënshkrimit të kontratës, respektivisht pasi të jetë bërë kërkesa nga Menaxheri i Kontratës i Punëdhënësit për fillim të punimeve dhe në rast se kushtet klimatike, nga palët nënshkruese të kësaj Kontrate, vlerësohen të përshtatshme për punë.

1.2 **Punëdhënësi obligohet që para fillimit të punimeve t'ia dorëzoi Punëmarrësit tërë dokumentacionin e kompletuar të projektit në fjalë.**

1.3 Projekti do të realizohet **brenda periudhës 2 ( dy ) vjeçare**, sipas afatit të përcaktuar në nenin 5.2 të FTD-së pjesë e Dosjes së Tenderit, Kushtet e Veçanta të Kontratës, **respektivisht jo më gjatë se data 30.08.2026**, bazuar dhe shumën e mjeteve të buxhetuara sipas viteve.

1.4 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Kontratës - Projektit si dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e punimeve sipas projektit.

1.5 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin.

1.6 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto çështje.

1.7 Punëmarrësi ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

1.8 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej **0,10%** të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustifikuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

1.9 Punëmarrësi, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik të punimeve, përmes afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se **12 ( dymbëdhjetë ) muaj + 1 ( një ) muaj** , e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të LMD-së që rregullojnë këtë çështje.

1.10 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.

1.11 **Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.**

1.12 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh pune nga dita e dërgimit të ftesës.

1.13 Në rast se Punëmarrësi në afatin e parapare nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit, duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.

1.14 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit jo adekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LDM-së që rregullojnë këtë çështje.

1.15 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do ti vërtetoi punimet e kryera sipas dinamikës, konformë specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

**Pranimi teknik i objektit**

1.16 Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkoi pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatoi procedurat e pranimit teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin mbi përfundimin e gjitha punëve të parapara.

1.17 Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitoi Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, **për një periudhë garantuese të defekteve prej 13 ( trembëdhjetë ) muajve** nga data e pranimit teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtjes së parasë.

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë në euro dhe kapë shumën prej: **59,900.00€ ( pesdhjetenëntmijnëntqind/00Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës - Projektit dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Shuma e pagesës në avans nuk aplikohet.

2.5 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit si dhe duke qenë se projekti në fjalë është projekt afatgjatë 2 ( dy ) vjeçar, ndërkaq prokurimi për realizimin e projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit që duhen përmbushur nga përvetësimet në vitin fiskal 2025 dhe 2026, palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare në këtë vit, 2025, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me nr. prok. **VU644 – 25 – 029 – 521,** respektivisht dinamika e realizimit të projektit të realizohet, me sa vijon :

**Projekti : Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në fsh. Ashlan**
**Në vitin 2025, deri në shumën : 20,000.00€, ndërsa**
**Në vitin 2026 deri në shumën : 23,670.00€**

**Projekti : Rregullimi i Parkut në Vushtrri**
**Në vitin 2025, deri në shumën : 16,230.00€.**

2.6 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(f) Plani për menaxhimin e kontratës;
(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.
3.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do ti marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me **nr. prokurimi : Vu644 – 25 – 3807 – 5-2-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 25 – 029 - 521**
3.4. **Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Komerciale në Prishtinë ( Departamenti për Çështje Ekonomike ), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me nr. prokurimi : VU644 – 25 – 3807 – 5-2-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 25 – 029 – 521**

**Neni 4 Komunikimet**
4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, e-mail ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.
4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.
4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.
4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në katër origjinale, prej të cilave 3 janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për : Autoritetin Kontraktues – Komuna Vushtrri**

**Për G.O.E. : " Ideal Partners "sh.p.k.** & "2D Group Corporation "sh.p.k. - **Drenas**

| **Emri:** | **Ilmi Azemi** | **Emri:** | **Kushtrim Berisha** |
|---|---|---|---|
| Pozita: | drejtor | Pozita: | drejtor |
| Nënshkrimi: | | Nënshkrimi: | |
| Data: | 24.06.2025 | Data: | 24.06.2025 |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## PARAMASA ME PARALLOGARI

Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtes dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve .
Punishtja të shenjëzohet dhe të vendosen tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkyqjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikyqjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese te cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.

## NDERTIMI I SHTEPIS TE KULTURES - OSHLAN

| A | ARKITEKTURA | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | PUNËT PËRGADITORE | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 1.1 | Mobilizimi i ndërmarrjes, paisjeve dhe materialeve për realizimin e punimeve, përgaditja e punishtes dhe mirembajtja e saj gjate periudhes se implementimin e punimeve. | komplet | 1.00 | 1,000.00 € | 1,000.00 € |
| 1.2 | Inqizimi I parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e aneksit, si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me organin mbikqyres. | komplet | 1.00 | 500.00 € | 500.00 € |
| 1.3 | Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantierit. | komplet | 1.00 | 250.00 € | 250.00 € |
| 1.4 | Punimi i rrethojës së kantierit. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm me llamarinë me lartësi 2 m. | m' | 150.00 | 8.00 € | 1,200.00 € |
| 1.5 | Furnizimi dhe montimi I tabeles informuese | komplet | 1.00 | 150.00 € | 150.00 € |
| 1.6 | Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit.Këtu përfshihen hapësira zyrat e menaxhimit të kantierit, mbikëçyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria) | komplet | 1.00 | 1,000.00 € | 1,000.00 € |
| 1.7 | Vendosja e kantierit | komplet | 1.00 | 500.00 € | 500.00 € |
| 1.8 | Furnizimi dhe montimi I skelev te cilat nevojiten gjate ndertimit | m2 | 100.00 | 5.00 € | 500.00 € |
| 1.9 | Pastrimi I parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale. | komplet | 1.00 | 350.00 € | 350.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 1: | 5,450.00 € |
| 2 | PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 2.1 | Gërmimi i gjerë i dheut(humusit) në thellësi mesatare h=40 cm për rrafshimin e terrenit, ku do të ndërtohet objekti. Materiali i gërmuar largohet në deponi legale të përcaktuar nga organi mbikqyrës. | $m^3$ | 50.00 | 10.00 € | 500.00 € |
| 2.2 | Gërmimi i dheut të kategorisë së III , IV dhe V-të për hapjen e themeleve shiritore të shtepis. Largimi i të njëjtit në largësi brenda kantierit për përdorim në rregullimin e oborrit, pjesa e teperet dhe e padobishme largohet në deponi legale të përcaktuar nga organi mbikqyrës. | $m^3$ | 50.00 | 10.00 € | 500.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.3 | Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-150 mm nën themelet mbi dheun e ngjeshur me mekanizim përkates. | m³ | 50.00 | 10.00 € | 500.00 € |
| 2.4 | Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-60mm në trashesi d= 20.0 cm mbi dheun e ngjeshur, perreth coklles nen pllaken e dysheme se objektit, ngjeshur me mekanizim përkates . | m³ | 50.00 | 15.00 € | 750.00 € |
| 2.5 | Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-32 mm në trashesi d= 15.0 cm i ngjeshur me mekanizim përkates nen pllaken e dysheme se objektit. | m³ | 50.00 | 15.00 € | 750.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 2: | 3,000.00 € |
| **3** | **PUNËT E BETONIT** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 3.1 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtresës së betonit me beton të ngjeshur C16/20 Mpa ne trashesi d =4-6 cm nën themelet shiritore të shtepis e cilia shërben si shtresë mbrojtëse e armaturës. | m³ | 5.00 | 70.00 € | 350.00 € |
| 3.2 | Furnizmi, transporti dhe betonimi i themelit me beton të armuar C 20/25 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Sipërfaqja e jashtme e pahive të jetë e lëmuar | m³ | 20.00 | 75.00 € | 1,500.00 € |
| 3.4 | Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C30/37 MPa në kallupet përkatëse sipas projektit. | cope | 6.00 | 80.00 € | 480.00 € |
| 3.5 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i elementeve tjera konstruktive si parahyrje.Me beton C25/30 në kallupet përkatese. | m³ | 5.00 | 80.00 € | 400.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 3: | 2,730.00 € |
| **4** | **PUNËT E ARMATURES** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 4.1 | Furnizimi, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURËS ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike. | kg | 950.00 | 0.80 € | 760.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 4: | 760.00 € |
| **5** | **PUNËT E MURATIMIT DHE SUVATIMIT** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 5.1 | Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të jashtme dhe të mbrendshme me blloka të argjlës d=25cm me llaq vazhdues | m² | 120.00 | 25.00 € | 3,000.00 € |
| 5.3 | Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të mbrendshme me blloka të argjlës d=12cm , muri me llaq vazhdues. | m² | 60.00 | 25.00 € | 1,500.00 € |
| 5.4 | Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe plafonit me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar.Ne pozicion të parashihet vendosja e kendoreve ne këndet e mureve. | m² | 250.00 | 15.00 € | 3,750.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 5: | 8,250.00 € |
| **6** | **PUNËT E KULMIT** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 6.1 | Furnizimi, punimi dhe montimi i konstruksionit të kulmit. Mahitë=10/12cm/;. Llogaria në siperfaqe te rrafshet $m^2$. | m² | 60.00 | 30.00 € | 1,800.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6.2 | Furnizmi, transporti dhe vendosja e dërrasave t=24mm mbi konstruksionin kulmit, si bazament për vendosjen e letrës difuzive dhe listelave. Llogaria në m$^2$ | m² | 60.00 | 10.00 € | 600.00 € |
| 6.3 | Furnizmi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave per krijimin e siperfaqes ajruese . Llogaria në siperfaqe te rrafshet m2 | m² | 60.00 | 10.00 € | 600.00 € |
| 6.4 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e letrës difuzive 110gr/m² mbi siperfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit te kulmit, perfshire te gjitha punët përgatitore. Llogaria në siperfaqe te rrafshet m2 | m² | 80.00 | 5.00 € | 400.00 € |
| 6.5 | Furnizmi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela. Llogaria në siperfaqe te rrafshet m2 | m² | 60.00 | 5.00 € | 300.00 € |
| | | | | **TOTALI POSICIONI 6:** | **3,700.00 €** |
| **7** | **PUNËT E LLAMARINËS** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 7.1 | Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit te objektit . Me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar d=0.55mm me brinje t=4cm - "Tip T50" (100% e mbuleses), perfshi kulmaret, aksesoret përcjellës për kompletim, dhe me shtresën kundër kondenzit, ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llogaria në m$^2$ në sipërfaqe të rrafshtë. | m² | 80.00 | 12.00 € | 960.00 € |
| 7.2 | Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm. | m' | 32.00 | 15.00 € | 480.00 € |
| 7.3 | Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve vertikal nga llamarina e plastifikuar me dimenzione Φ12cm, t=0.55mm | m' | 41.00 | 15.00 € | 615.00 € |
| | | | | **TOTALI POSICIONI 7:** | **2,055.00 €** |
| **8** | **PUNËT E ZDRUKTHËTARISË** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 8.1 | DRITARE TE JASHTME NGA PVC<br>Furnizimi dhe montimi I dritareve te jashtme:<br>- Permasat:90/115 cm<br>- Shtoku: PVC<br>- Me trashesi te kornizes min t=8 mm dhe me xham 4 mm solar +14 mm argon + 4 mm float +14 mm argon + 4 mm Low E, Uw < 1.2 W/m²K. Në llogaritje përfshihen të gjitha elementet fiksuese, dorëzat, përpunimi i mureve të dëmtuara gjatë procesit të ndërrimit në pjesën e brendshme, sipas Manualeve të Prodhuesit, Specifikimit Teknik, Tekstura antracid. | cope | 4.00 | 300.00 € | 1,200.00 € |
| 8.2 | DRITARE TE JASHTME NGA PVC<br>Furnizimi dhe montimi I dritareve te jashtme:<br>- Permasat:60/60 cm<br>- Shtoku: PVC<br>- Me trashesi te kornizes min t=8 mm dhe me xham 4 mm solar +14 mm argon + 4 mm float +14 mm argon + 4 mm Low E, Uw < 1.2 W/m²K. Në llogaritje përfshihen të gjitha elementet fiksuese, dorëzat, përpunimi i mureve të dëmtuara gjatë procesit të ndërrimit në pjesën e brendshme, sipas Manualeve të Prodhuesit, Specifikimit Teknik, Tekstura antracid. | cope | 2.00 | 220.00 € | 440.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 8.3 | DERA E JASHTME NGA PVC<br>Furnizimi dhe montimi I deres se jashtme:<br>- Permasat 150*210cm<br>- Shtoku: PVC<br>- Me trashesi te kornizes min t=8mm dhe me xham 4 mm solar +14 mm argon + 4 mm float +14 mm argon + 4 mm Low E, Uw < 1.2 W/m²K. Në llogaritje përfshihen të gjitha elementet fiksuese, dorëzat, përpunimi i mureve të dëmtuara gjatë procesit të ndërrimit në pjesën e brendshme, sipas Manualeve të Prodhuesit, Specifikimit Teknik, Tekstura antracid | cope | 1.00 | 330.00 € | 330.00 € |
| 8.4 | Furnzimi dhe montimi I dyereve të brendshme NGA PVC<br>Furnizimi dhe montimi I dyerve te bredshme:<br>- Permasat DERA:80/210 cm<br>- Shtoku: PVC<br>- Krahu: krahu prej PVC<br>- Tesktura sipas projektit<br>- Profili me diameter te bazes Min. 8cm | cope | 3.00 | 330.00 € | 990.00 € |
| 8.5 | Furnzimi dhe montimi I kuzhines per nevoja te Objektit | Cope | 1.00 | 500.00 € | 500.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 8: | 3,460.00 € |
| **9** | **PUNËT E GLETIT DHE FASADËS** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 9.1 | Furnizimi, transporti dhe ekzekutimi i gledit të të gjitha mureve të brendshme dhe pllafoneve në objektin, në dy shtresa (ketu nuk parashihen muret te nyjet sanitare), paraprakishte të behet pergaditja me lëndën bazë, siperfaqja duhet të jetë e lëmuar dhe e gatshme për ngjyrosje. | m² | 250.00 | 10.00 € | 2,500.00 € |
| 9.3 | Furnizimi, transporti dhe punimi me stiroprit N4 i fasadës së jashtme për objektin, me trashësi t=10cm sipas projektit. Në çmim të llogaritet ngjitesi dhe elementet lidhese-tipllat. | m² | 100.00 | 25.00 € | 2,500.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 9: | 5,000.00 € |
| **10** | **PUNËT E NGJYROSJES** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 10.1 | Furnizimi, transporit dhe ngjyrosja e mureve, pllafoneve të kthinave mbi bazament të gletuar te objekti , me polikolor ne dy shtresa me nuancë të bardhë. | m² | 250.00 | 4.00 € | 1,000.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 10: | 1,000.00 € |
| **11** | **PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 11.1 | Furnizimi, transporti dhe mveshja e mureve (sanitaret) të objektit me pllaka të keramikës të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit | m² | 15.00 | 30.00 € | 450.00 € |
| 11.2 | Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshmeve të objektit me Laminat të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit. | m² | 55.00 | 13.00 € | 715.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 11: | 1,165.00 € |
| **12** | **PUNËT E DYSHEMESË** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 12.1 | Furnizimi i materialit, transporti dhe punimi i shtreses së estrihut në pllakën e dyshemes dhe katit të objektit me makinë me trashësi 4cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese striroporit t=3cm dhe shtresës hidroizoluese. | m² | 60.00 | 15.00 € | 900.00 € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12.2 | Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses mbrojtese (estrih) te objekti me makinë me trashësi 4-5 cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese nën konstruksionin e kulmit. | m² | 60.00 | 15.00 € | 900.00 € |
| | | | | **TOTALI POSICIONI 12:** | 1,800.00 € |
| **13** | **PUNËT TJERA** | | | | |
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 13.1 | Furnizimi me material dhe punimi i pikoreve te jashtme te dritareve dhe hapjeve te nevojshme nga llamarina e plastifikuar tek pjesa e fasades me tulla me gjerësi 25÷45cm , ngjyra sipas perzgjedhjes se OM. Ne çmim të parashihet kthimi, ankerimi i pikores nene dritare, aksesoret, ngjitësi/ silikoni Sika dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion . Llogaritet në metër gjatësi të shtrirë/punuar. | cope | 6 | 50.00 € | 300.00 € |
| | | | | **TOTALI POSICIONI 13:** | **300.00 €** |
| | | | | | |

| **A** | **REKAPITULIM** | |
|---|---|---|
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Shuma** |
| 1 | PUNËT PËRGADITORE | 5,450.00 € |
| 2 | PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA | 3,000.00 € |
| 3 | PUNËT E BETONIT | 2,730.00 € |
| 4 | PUNËT E ARMATURES | 760.00 € |
| 5 | PUNËT E MURATIMIT DHE SUVATIMIT | 8,250.00 € |
| 6 | PUNËT E KULMIT | 3,700.00 € |
| 7 | PUNËT E LLAMARINËS | 2,055.00 € |
| 8 | PUNËT E ZDRUKTHËTARISË | 3,460.00 € |
| 9 | PUNËT E GLETIT DHE FASADËS | 5,000.00 € |
| 10 | PUNËT E NGJYROSJES | 1,000.00 € |
| 11 | PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT | 1,165.00 € |
| 12 | PUNËT E DYSHEMESË | 1,800.00 € |
| 13 | PUNËT TJERA | 300.00 € |
| | **TOTALI -A- ARKITEKTURA:** | **38,670.00 €** |

| **B** | **INSTALIMET ELEKTRIKE** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Poz.** | **Përshkrimi I pozicionit** | **Njësia matëse** | **Sasia** | **Çmimi për njësi (€)** | **Totali (€)** |
| 14 | Furnizimi dhe montimi i te gjitha pjeseve te instalimeve elektrike duke perfshir :1.Kabllimin elektrik me te gjitha fazat percjellse , 4.Impianti I Tokezimit & Impianti Rrufeprites,5.Kuadrot Elektrik Te Shperndarjes 6. Kabina Elektrike, Ndricues LED, Ndricues dekorativ, te gjitha keto duhet te llogariten me elementet percjellse deri ne finalizim si dhe te behet testimi i tyre. | komplet | 1.00 | 2,000.00 € | 2,000.00 € |
| | | | | **TOTALI POSICIONI B:** | **2,000.00 €** |

| C | INSTALIMET HIDROTEKNIKE DHE SANITARE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përshkrimi i pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 15 | Furnizimi dhe montimi I te gjitha pjeseve hidroteknike dhe hidrosanitare duke perfshir: 1.KANALIZIM FEKAL,ATMOSFERIK,DRENAZHIM,UJËSJELLËSI 2.SANITARI (LAVAMAN,GUACK,N)te gjitha keto duhet te llogariten me elementet percjellse deri ne finalizim si dhe te behet testimi i tyre. | komplet | 1.00 | 3,000.00 € | 3,000.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI C: | 3,000.00 € |

| NDERTIMI I SHTEPIS TE KULTURES - RIKAPITULIM | | |
|---|---|---|
| Nr. | PËRSHKRIMI I PUNËVE | Shuma Totale (€) |
| A | ARKITEKTURA | 38,670.00 € |
| B | INSTALIMET ELEKTRIKE | 2,000.00 € |
| C | INSTALIMET HIDROTEKNIKE | 3,000.00 € |
| | TOTAL I PERGJITHSHEM | 43,670.00 € |

| RREGULLIMI I PARKUT NE VUSHTRRI | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| A | ARKITEKTURA | | | | |
| 1 | PUNËT PËRGADITORE | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 1.1 | Mobilizimi i ndërmarrjes, paisjeve dhe materialeve për realizimin e punimeve, përgaditja e punishtes dhe mirembajtja e saj gjate periudhes se implementimin e punimeve. | komplet | 1.00 | 1,000.00 € | 1,000.00 € |
| 1.2 | Furnizimi dhe montimi I tabeles informuese | komplet | 1.00 | 200.00 € | 200.00 € |
| 1.3 | Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit.Këtu përfshihen hapësira zyrat e menaxhimit të kantierit, mbikëçyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria) | komplet | 1.00 | 1,000.00 € | 1,000.00 € |
| 1.4 | Pastrimi I parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale. | komplet | 1.00 | 1,000.00 € | 1,000.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 1: | 3,200.00 € |
| 2 | PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 2.1 | Gërmimi i dheut(humusit) dhe furnzimi,ngjeshja e dheut në thellësi mesatare h=40cm për rrafshimin e terrenit. Materiali i gërmuar largohet në deponi legale të përcaktuar nga organi mbikqyrës. | $m^3$ | 70.00 | 8.00 € | 560.00 € |
| 2.2 | Demolimi I kubezave te betonit ne rastet ku nevojitet intervenimi. | m2 | 60.00 | 10.00 € | 600.00 € |
| 2.3 | Rivendosja e kubzave te betonit.Ne cmim te perfshihet vendosja dhe ngjeshja e kubzave ekzistuese. | m3 | 60.00 | 10.00 € | 600.00 € |
| 2.3 | Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e reres(0-4mm) per kocka te betonit duke ngjeshur me mekanizim përkates(papuqe) | $m^3$ | 15.00 | 15.00 € | 225.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 2: | 1,985.00 € |
| 3 | PUNËT E BETONIT | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 3.1 | Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtresës së betonit me beton C25/30 me trashesi 30-40 cm per shtangimin e Shtyllave elektrike.Betonimi I themeleve perforcuese me dimensione 30/30 cm. | cope | 4.00 | 80.00 € | 320.00 € |

| | | | | TOTALI POSICIONI 3: | 320.00 € |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | PUNËT E ELEKTRIKES | | | | |
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 4.1 | Zhvendosja e shtyllave elektrike dhe hudhja e tyre deri ne deponi te qytetit | cope | 4.00 | 200.00 | 800.00 € |
| 4.2 | Furnzimi me shtylla elektrike, forma dhe dizajni percaktohet nga organi mbikqyres | cope | 4.00 | 350.00 | 1,400.00 € |
| 4.3 | Lyerja e shtyllave elektrike ekzistuese, ngjyra antracid. | cope | 20.00 | 20.00 | 400.00 € |
| 4.4 | Riparimi I shtyllave elektrike, ndrrimi I poqave te demtuar dhe zevendesimi I tyre me poqa te ri, | cope | 20.00 | 25.00 | 500.00 € |
| 4.5 | Testimi I rrjetit elektrik ekzistues | komplet | 1.00 | 500.00 € | 500.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 4: | 3,600.00 € |

| 5 | PUNËT TOKSORE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Poz. | Përshkrimi I pozicionit | Njësia matëse | Sasia | Çmimi për njësi (€) | Totali (€) |
| 5.1 | Pastrimi I kubeza dhe hudhja e mbeturinav ne deponi te qytetit. | m2 | 10 | 30.00 | 300.00 € |
| 5.2 | Riparimi I kubezave te betonit ku ka nevoje per nderhyrje | m2 | 10 | 35.00 | 350.00 € |
| 5.3 | Furnizimi, transporti dhe mbjellja e barit për sipërfaqet e parkut, i çertifikuar. Mbillet në në thellësi 0,5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojshme për 1 m2 është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindra të rëndë dhe ujitja me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m2 treset dhe 15-20 g/m2 pleh mineral i kombinuar NPK. . Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. | komplet | 1 | 500.00 | 500.00 € |
| 5.5 | Furnizimi dhe mbiellja e pemeve | cope | 30 | 20.00 | 600.00 € |
| 5.5 | Furnizimi me ulese dhe montimi I tyre | cope | 7 | 150.00 | 1,050.00 € |
| 5.6 | Furnizimi dhe vendosja e shportave per hudhjen e mbeturinave. | cope | 15 | 20.00 | 300.00 € |
| 5.7 | Furnizimi I shportave me lule dhe vendosja e tyre tek muri ekzistues | cope | 15 | 15.00 | 225.00 € |
| 5.8 | Furnizimi, transporti dhe montimi i mveshjes se drurit ne fasaden e murit ekzistues. Fasada duhet te punohet ne perputhje me udhezimet e organit mbikqyres dhe detalizimit ne projekt. Druri duhet te jet I impregnuar dhe rezistent ne ambiente te jashtme. | m' | 15 | 20.00 | 300.00 € |
| 5.8 | Furnizimi transporti dhe montimi I kendit te lodrave per femije te dy llojeve:<br>1.Kendi i lodrave per femije i grupmoshes 2 - 4 vjet<br>2.Kendi i lodrave per femije i grupmoshes 5 + vjet. Lloji i kendit te lodrave per femije eshte percaktuar ne detalet e projektit dhe montimi i tyre duhet te jete sipas udhezimeve te prodhuesit.Materialet e perdorura te keni i lodrave per femije duhet te jete sipas standarteve te EU. | komplet | 350.00 | 10.00 € | 3,500.00 € |
| | | | | TOTALI POSICIONI 5: | 7,125.00 € |

| RREGULLIMI I PARKUT NE VUSHTRRI RIKAPITULIM | | |
|---|---|---|
| Nr. | PËRSHKRIMI I PUNËVE | Shuma Totale (€) |
| 1 | ARKITEKTURA | 3,200.00 € |
| 2 | PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA | 1,985.00 € |

| | | |
|---|---|---|
| 3 | PUNËT E BETONIT | 320.00 € |
| 4 | PUNËT E ELEKTRIKES | 3,600.00 € |
| 5 | PUNËT TOKSORE | 7,125.00 € |
| | TOTAL I PERGJITHSHEM | 16,230.00 € |

| REKAPITULIMI I PERGJIGHSHEM | | |
|---|---|---|
| Nr. | PËRSHKRIMI I PUNËVE | Shuma Totale (€) |
| 1 | NDERTIMI I SHTEPIS TE KULTURES - RIKAPITULIM | 43,670.00 € |
| 2 | RREGULLIMI I PARKUT NE VUSHTRRI RIKAPITULIM | 16,230.00 € |
| | TOTALI I PERGJITHSHEM | 59,900.00 € |

SH.P.K. 2D GROUP CORPORATION 811913913 Prishtinë

SH.P.K. IDEAL PARTNERS

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: **VU644-25-3807-5-2-1/C1047**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

| | | |
|---|---|---|
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | | 2.1 |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë : **gjuhët zyrtare në vend.** |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës.<br><br>Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti në kohëzgjatje prej 13 muaj nga data e nënëshkrimit të kontratë. |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve *[shëno shumat]*;<br>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve *[shëno shumat]*;<br>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën *[shëno shumat]*;<br>(d) dëmtim personal ose vdekje:<br>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: *[shëno shumat]*<br>(ii) të personave të tjerë: *[shëno shumat]* |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda **2 ( ditë )** ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është : konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë : 4 (katë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë. |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas Planit Dinamik , por jo më gjatë se afat i përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.<br>- fillimi i punimeve: 4 (katër) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës. |

| | | |
|---|---|---|
| Regjistri i punës | 20.1 | Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit - Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Librin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | **Menaxheri i Projektit dhe Organi mbikëqyrës** : do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës.<br><br>Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin. |
| Pagesa | 24.1 | Pagesa do të kryhet sipas situacioneve të aprovuara nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.<br><br>Pgaesa do të kryhet në afatin sa më të shkrtër kohor, por jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjregjës për pranimin dhe protokolimin e faturave i AK-së. |
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: **N / A** |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: **N / A** |
| Shkaqet për kompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 40 (katërdhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të punimeve, konform Planit dinamik por jo më gjatë se Plani dinamik i përcaktuar në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm në shumë prej 10% te vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objektet sipas :<br><br>Dokumentit – Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të punëve. |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Në pajtim me nenin 42 të Kushtëve të Përgjitheshme të Kontratës |
| Zgjidhja e | 43.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të |

| | | |
|---|---|---|
| mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | | lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.** |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : **Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.** |